

<p><i>Acquis</i> së BE-sëqë synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare)</p> <p>Nr. CELEX: 2008L0056</p> <p>DIREKTIVA 2008/56/KE e PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KESHILLIT e datës 17 Qershor 2008 “Për krijimin e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikave mjedisore detare”, ndryshuar nga Direktiva (EU) 2017/845 e 17 maj 2017. (OJ L 125/27, 18.05.2017)</p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit)</p> <p>ProjektLigj “Për Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë”</p> <p>Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur</p> <p>Shkalla e Përafrimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafuar kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë.
Neni 1, pika 1	Kjo Direktivë përcakton një kuadër brenda së cilës Shtetet Anëtare duhet të ndër marrin masat e nevojshme për të arritur		Neni 1	Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për arritjen dhe mirëmbajtjen e një statusi të mirë mjedisor të ujërave detare të Detit	E Plotë	

	apo ruajtur statusin e mirë mjedisor në mjedisin detar jo më vonë se viti 2020.			Mesdhe, të cilat janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.		
Neni 1, pika 2	2. Për këtë qëllim duhet të hartohen dhe zbatohen strategji detare me qëllim:		Neni 2 pika 1, paragrafi i parë	1. Objekti i këtij ligji është hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së mbrojtjes së mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë me synim:	E Plotë	
Neni 1, pika 2 (a)	(a) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar, parandalimin e degradimit të tij, apo në ato raste kur është e praktikueshme, restaurimin e ekosistemeve detare në zona ku ka patur ndikim negativ;		Neni 2 pika 1 shkronja a, b, c,	a) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar; b) parandalimin e përkeqësimit të mjedisit detar; c) restaurimin e ekosistemeve detare që janë prekur negativisht; si dhe	E plotë	
Neni 1, pika 2 (b)	(b) parandalimin dhe reduktimin e inputeve në mjedisin detar, me qëllim zhdukjen e ndotjes siç është përcaktuar në Nenin 3(8), për tu siguruar që nuk ka ndikime domethënëse apo rreziqe për biodiversitetin detar, ekosistemet detare, shëndetin e njerëzve apo për përdorimet legjitime të detit.		Neni 2 pika 1, shkronja ç	ç) parandalimin dhe uljen e hedhjeve në mjedisin detar, me qëllim eliminimin gradual të ndotjes, siç përcaktohet në pikën 6, të nenit 4 të këtij ligji, për të siguruar që nuk ka ndikime apo rreziqe të rëndësishme ndaj biodiversitetit detar, ekosistemeve detare, shëndetin e njeriut apo përdorimet e ligjshme të detit.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 1 shkronja (ç) (neni 4) e projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 1, pikën 2 shkronjën(b) e Direktivës (neni 3 (8)).
Neni 5, pika 1	Çdo Shtet Anëtar në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të hartojë një strategji detare për ujërat e veta detare, në përputhje me planin e veprimit të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2.		Neni 2, pika 2	2. Për përmbushjen e objektit të këtij ligji të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të hartohen strategji të veçanta për mbrojtjen e mjedisit detar për nënrajonet detare nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.	E Pjesshme	
Neni 2, pika 1	1. Kjo Direktive do të zbatohet për të gjitha ujërat detare sipas		Neni 3 pika 1	1. Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në të gjitha ujërat	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 3, pika 1 e projektligjit

	përcaktimit të Nenit 3(1) dhe do të marrë në konsideratë efektet ndërkufitare mbi cilësinë e mjedisit detar të shtetit të tretë në rajonin apo nën-rajonin detar.			detare, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji, dhe do të marrin parasysh ndikimet ndërkufitare në cilësinë e mjedisit detar të shteteve të tjera me të cilat Shqipëria ndan sovranitetin e saj mbi ujërat detare të nënrajonit I dhe nënrajonit II, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji.		(neni 4) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 2, pika 1 e Direktivës (neni 3(1))
Neni 2, pika 2	Kjo Direktivë nuk do të zbatohet për aktivitete qëllimi i vetëm i të cilave është mbrojtja apo siguria kombëtare. Megjithatë, Shtetet Anëtare do të përpiqen të sigurohen që këto aktivitete të zhvillohen në mënyre të përputhshme, sa më shumë të jetë e mundur, me objektivat e kësaj Direktive.		Neni 3, pika 2	2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga organet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, për hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin detar, për zonat e mbrojtura detare, për biodiversitetin dhe monitorimin e ujërave detare.	E Pjesshme	
Neni 3, pika 1 shkronja (a)	1. "ujëra detare" ka kuptimin: (a) ujërat, fundi i detit dhe tokës nga ana e detit nga e cila maten ujërat territoriale deri në skajin më të fundit të të drejtave juridiksionale të një Shteti Anëtar, në përputhje me marrëveshjen Unclos, me përjashtim të ujërave ngjitur me vendet dhe territoret e përcaktuara në Aneksin II të Traktatit dhe të French Overseas Departments and Collectivities; dhe		Neni 4, pika 16, shkronja (a)	16. "Ujëra detare" janë: a) ujërat, shtrati i detit dhe nëntoka në anën e detit të vijës bazë nga e cila matet shtrirja e ujërave territoriale, duke u shtrirë deri në kufijtë e zonës ku Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat e sovranitetit, në përputhje me Konventën e OKB-së për të drejtën e detit (UNCLOS, 1982);	E Plotë	Sqarojmë se marrëveshja e UNCLOS e referuar në Nenin 3, pika 1, gërma (a) të Direktivës është në përputhje me referencën e paraqitur në nenin 4, pika 16, shkronja (a). Republika e Shqipërisë ka aderuar në kësaj Konventë që në vitin 2003, përmes ligjit nr. 9055, datë 24.04.2003.

Neni 3 pika 1 shkronja (b)	(b) ujërat bregdetare sipas përkufizimit të Direktivës 2000/60/KE, shtrati i tyre dhe nëntoka, përsa kohë lidhet me aspekte të veçanta të statusit mjedisor që nuk trajtohen nga ajo Direktivë apo nga ndonjë legjislacion tjetër i Komunitetit;		Neni 4, pika 16, shkronja (b)	b) ujërat bregdetare, shtrati i detit dhe nëntoka e tyre, në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në legjislacionin për burimet ujore, për aq sa aspektet e veçanta të statusit mjedisor të mjedisit detar nuk trajtohen prej tij apo një legjislacion tjetër;	E plotë	Përkufizimi i dhënë në legjislacionin për burimet ujore, është në përputhje me përkufizimin e të Direktivës 2000/60/KE
Neni 3, pika 2	"rajon detar" ka kuptimin e një rajoni detar të evidentuar në Nenin 4. Rajonet detare dhe nën-rajonet e tyre përcaktohen me qëllim lehtësimin e zbatimit të kësaj Direktive, dhe përcaktohen duke marrë në konsideratë karakteristikat e tyre hidrologjike, oqeanografike dhe biogeografike;		Neni 4, pika 10	10. "Rajon detar" është Deti Mesdhe (Mesdheu);	E Plotë	
Neni 3, pika 3	3. "strategjia detare" i referohet strategjisë që do të hartohet dhe zbatohet në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar të parashtruar në Nenin 5;		Neni 4, pika 15	15. "Strategji për mbrojtjen e mjedisit detar" është Strategjia që do të hartohet dhe zbatohet në lidhje me nënrajonin I dhe II në Shqipëri, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji;	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 3 pika 3 e Direktivës, është transpozuar nga referenca e vendosur në nenin 4 pika 15 e projektligjit.
Neni 3, pika 4	4."statusi mjedisor" i referohet gjendjes së përgjithshme të mjedisit në ujërat detar, duke marrë në konsideratë strukturën, funksionin dhe proceset e ekosistemeve detare bashkë me faktorët natyrorë fiziografike, gjeografike, biologjike, gjeologjike dhe klimaterike, si edhe me kushtet akustike dhe kimike, duke përfshirë kushtet		Neni 4, pika 13	13. "Status mjedisor" është gjendja e përgjithshme e mjedisit në ujërat detare, duke marrë parasysh strukturën, funksionin dhe proceset e ekosistemeve detare përbërëse, së bashku me faktorët natyrorë fiziografikë, gjeografikë, biologjikë, gjeologjikë dhe klimatikë, si dhe kushtet fizike, akustike dhe kimike, përfshirë ato që rezultojnë nga	E Plotë	

	që rezultojnë nga aktivitetet njerëzore brenda dhe jashtë zonës në fjalë;			veprimtaria njerëzore brenda ose jashtë zonës në fjalë;		
Neni 3, pika 5, paragrafi i parë	5."status i mirë mjedisor" ka kuptimin e statusit mjedisor të ujërave detare që krijojnë oqeanë ekologjikisht të ndryshme dhe dinamike dhe detra të pastra, të shëndoshë dhe produktivë brenda kushteve të tyre të brendshme, si edhe përdorimi i mjedisit detar është në një nivel që është i qëndrueshëm, duke ruajtur kështu potencialin për përdorimin dhe aktivitetet nga brezat e sotshëm dhe të ardhshëm, dmth:		Neni 4, pika 14, paragrafi i parë	14. "Status i mirë mjedisor" është statusi mjedisor i ujërave detare, ekologjikisht të larmishme dhe dinamike, i cili është i pastër, i shëndetshëm dhe produktiv brenda kushteve të tij të brendshme, ndërsa përdorimi i mjedisit të tij detar është në një nivel të qëndrueshëm, duke mbrojtur kështu potencialin për t'u përdorur nga brezat aktualë dhe të ardhshëm, ku përfshihet:	E plotë	
Neni 3, pika 5, shkronja (a)	(a) struktura, funksionet dhe proceset e ekosistemeve detare bashkë me faktorët natyrorë fiziografike, gjeografike, biologjike, gjeologjike dhe klimaterike, bëjnë të mundur funksionimin e plotë të këtyre ekosistemeve dhe ruajtjen e reziliencës të tyre ndaj ndryshimeve mjedisore të shkaktuara nga dora e njeriut. Speciet dhe habitatet detare janë të mbrojtura, degradimi i biodiversitetit i shkaktuar nga dora e njeriut parandalohet dhe komponentet biologjike		Neni 4, pika 14, shkronja (a)	a) struktura, funksionet dhe proceset e ekosistemeve detare përbërëse, së bashku me faktorët e lidhur fizik, gjeografikë, biologjik, kimikë, gjeologjikë dhe klimatikë, lejojnë që këto ekosisteme të funksionojnë plotësisht dhe të ruajnë qëndrueshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve mjedisore të shkaktuara nga dora e njeriut. Speciet detare dhe habitatet janë të mbrojtura, rënia e biodiversitetit e shkaktuar nga dora e njeriut është parandaluar dhe përbërësit e ndryshëm biologjikë funksionojnë në ekuilibër;	E plotë	

	funksionojnë në mënyrë të balancuar;					
Neni 3, pika 5 shkronja (b), paragrafi i parë	(b) vetitë hidromorfologjike, fizike dhe kimike të ekosistemeve, duke përfshirë ato veti që rezultojnë nga aktivitetet njerëzore në fushat në fjalë, mbështesin ekosistemet e lartpërmendura. Inputet antropogjenike të substancave dhe energjisë, duke përfshirë zhurmat, në mjedisin detar nuk shkaktojnë efekte ndotëse;		Neni 4, pika 14, shkronja (b)	b) vetitë hidromorfologjike, fizike dhe kimike të ekosistemeve, përfshirë ato veti që rezultojnë nga veprimtaria njerëzore në zonën në fjalë, mbështesin ekosistemet siç përshkruhet më sipër. Prurjet antropogjene të substancave dhe energjisë, përfshirë zhurmën, në mjedisin detar nuk shkaktojnë efekte të ndotjes.	E plotë	
Neni 3, pika 5 shkronja (b), paragrafi i dytë	Statusi i mirë mjedisor do të përcaktohet në nivelin e rajoneve apo nën-rajoneve detare, sic është referuar në Nenin 4, mbi bazën e përshkruesve cilësore të Aneksit I. Manaxhimi i adaptueshëm sipas qasjes të ekosistemit do të aplikohet me qëllim arritjen e statusit të mirë mjedisor;		Neni 4, pika 14, shkronja (c)	c) statusi i mirë mjedisor, në nivelin e nënrajoneve detare I dhe II, do të përcaktohet në bazë të karakteristikave cilësore të përcaktuara në këtë ligj. Do të zbatohet menaxhimi përshtatës sipas qasjes së orientuar nga ekosistemi, me qëllim arritjen e statusit të mirë mjedisor;	E Pjesshme	
Neni 3, pika 6	"kriteret" janë tiparet dalluese teknike që lidhen ngushtë me përshkruesit cilësorë;		Neni 4, pika 5	5. "Kriteret" janë karakteristikat dalluese teknike që janë të lidhura ngushtë me karakteristikat cilësore;	E Plotë	
Neni 3, pika 7	"objektivi/target mjedisor" ka kuptimin e një deklarate cilësore apo sasiore në lidhje me kushtet e dëshiruara të komponentëve të ndryshëm dhe trysnive apo ndikimeve në ujërat detare në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar. Objektivat		Neni 4, pika 9	9. "Objektiv mjedisor" është gjendja cilësore ose sasiore e synuar e përbërësve të ndryshëm të ujërave detare në nënrajonet detare I dhe II, si dhe e presioneve dhe ndikimeve mbi to. Objektivat mjedisore përcaktohen në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;	E Pjesshme	Referenca e vendosur në nenin 4, pika 9 e projektligjit (neni 10) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 3 pikën 7 të Direktivës (neni 10).

	mjedisore përcaktohen në përputhje me Nenin 10;					
Neni 3, pika 8	"ndotja" ka kuptimin e induktimeve direkte apo indirekte, si rezultat i aktivitetit njerëzor, të substancave apo energjisë, duke përfshirë zhurmat detare nënujore të shkaktuara nga njeriu, rezultatet e të cilave mund të kenë ndikime negative dëmtuese si p.sh. dëmtime të burimeve të gjalla dhe ekosistemeve detare, duke përfshirë humbjen e biodiversitetit, rreziqet ndaj shëndetit të njeriut, parandalimin e aktiviteteve detare, duke përfshirë peshkimin, turizmin, aktivitete argëtimi dhe përdorime të tjera legjitime të detit, ndikime negative në cilësinë e përdorimit të ujit të detit dhe ulje në përgjithësi të elementeve negative në përdorimin e qëndrueshëm të mallrave dhe shërbimeve detare;		Neni 4, pika 6	6. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose tërthorazi në mjedisin detar, si pasojë e veprimtarisë njerëzore, e substancave dhe energjisë, përfshirë zhurmat në ujërat detare të shkaktuara nga dora e njeriut, gjë që sjell apo ka gjasa të sjellë si pasojë ndikime të dëmshme, të tilla si dëmtimi i gjallesave dhe ekosistemeve detare, përfshirë humbjen e biodiversitetit, rreziqet ndaj shëndetit të njeriut, pengesat ndaj veprimtarive detare, përfshirë peshkimin, turizmin dhe përdorime të tjera të ligjshme të detit, dëmtimi i cilësisë për përdorimin e ujit të detit dhe zvogëlimi i pajisjeve ose, në përgjithësi, dëmtimi i përdorimit të qëndrueshëm të mallrave dhe shërbimeve detare;	E Plotë	
Neni 3, pika 9	"bashkëpunimi rajonal" ka kuptimin e aktiviteteve të bashkëpunimit dhe koordinimit midis Shteteve Anëtare dhe kur është e mundur me vendet e treta që ndajnë të njëjtin rajon apo nën-rajon detar me qëllim hartimin dhe zbatimin e strategjive detare;		Neni 4, pika 2	2. “Bashkëpunimi rajonal” është bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarive mes shteteve që ndajnë sovranitetin mbi Detin Adriatik dhe Detin Jon, kur është e mundur, me vendet e rajonit detar Mesdhetar dhe nënrajoneve detare I dhe II, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e	E Plotë	

				strategjive për mbrojtjen e mjedisit detar;		
Neni 3, pika 10	"konventa rajonale detare" ka kuptimin e çdo konvente ndërkombëtare apo marrëveshjeje ndërkombëtare bashkë me njësitë qeverisëse të ngritura me qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të rajoneve detare të përcaktuara në Nenin 4, si p.sh.: Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Detit Balltik; Konventa për mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Veri-Lindor dhe Konventa për Mjedisin Detar dhe Rajonin Bregdetar të Detit Mesdhe.		Neni 4, pika 4	4. "Konventa rajonale e detit" është Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe, përfshirë protokollet e ratifikuara, Konventa e Barcelonës e vitit 1976;	E Plotë	Sqarojmë se ky përkufizim është përshtatur në kontekstin kombëtar, dhe është përfshirë Konventa për mbrojtjes e Mjedisit detar dhe zonës Bregdetare të Detit Mesdhe (Konventa e Barcelonës) si reference pasi ujërat detarë nën sovranitetin e RSH bëjnë pjesë në detin Mesdhe. RSH ka aderuar në këtë konventë si dhe të protokolleve të saj përmes ligjit nr. 8690, datë 16.11.200.
Neni 5, pika 1 paragrafi 1	1. Çdo Shtet Anëtar në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të hartojë një strategji detare për ujërat e veta detare, në përputhje me planin e veprimit të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2.		Neni 5, pika 1	1. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë hartohet sipas fazave të mëposhtme:	E Plotë	
Neni 5, pika 2, shkronja (a)	(a) përgatitja:		Neni 5, pika 1, shkronja (a)	a) faza përgatitore, e cila përbëhet nga:	E Plotë	
Neni 5, pika 2, shkronja (a) (i)	(i) një vlerësim fillestar duhet të përfundojë deri me datë 15 Korrik 2012 në lidhje me statusin aktual mjedisor të ujërave në fjalë dhe ndikimin mjedisor të aktiviteteve njerëzore të zhvilluara në to, në përputhje me Nenin 8;		Neni 5, pika 1, shkronja (a) (i),	i) vlerësimi fillestar i statusit aktual mjedisor të ujërave detare të nënrajoneve detare I dhe II dhe ndikimit mjedisor të veprimtarisë njerëzore mbi to, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pikën 1, shkronjën (a) (i) (neni 8), të projektligjit është në përputhje të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2, shkronjën (a) (i)(neni 8) të Direktivës.

Neni 5, pika 2, shkronja (a) (ii)	(ii) përcaktim të statusit të mirë mjedisor që do të bëhet deri me datë 15 Korrik 2012 për ujërat në fjalë, në përputhje me Nenin 9(1);		Neni 5, pika 1, shkronja (a) (ii),	ii) përcaktimi i statusit të mirë mjedisor të ujërave detare, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;	E Pjeshsme	Referenca e vendosur në nenin 5, pikën 1, shkronjën (a) (ii) të projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2, shkronjën (a) (ii) të Direktivës
Neni 5, pika 2, shkronja (a) (iii)	(iii) përcaktimin deri me datë 15 Korrik 2012 të një sërë objektivash mjedisore dhe treguesve përkatës, në përputhje me Nenin 10(1);		Neni 5, pika 1, shkronja (a) (iii)	iii) përcaktimi i objektivave mjedisore dhe treguesve të lidhur me to për ujërat detare, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pikën 1, shkronjën (a) (iii) të projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2, shkronjën (a) (iii) të Direktivës
Neni 5, pika 2, shkronja (a) (iv)	(iv) përcaktimin dhe implementimin deri me datë 15 Korrik 2014, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në legjislacionin përkatës të Komunitetit, të një programi monitorimi për një vlerësim në vazhdimësi dhe përditësim në vazhdimësi të objektivave, në përputhje me Nenin 11(1);		Neni 5, pika 1, shkronja (a), (iv) dhe (v)	iv) krijimi dhe zbatimimi i programit të monitorimit për vlerësimin e vazhdueshëm dhe përditësimin e rregullt të objektivave, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji; v) publikimi i raporteve dhe raportimi i tyre në përputhje me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji;	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pikën 1, shkronjën (a), (iv) të projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2, shkronjën (a) (iv) të direktivës.
Neni 5, pika 2, shkronja (b), (i)	(b) programi i masave: (i) hartimi, jo më vonë se viti 2015, i një programi masash për arritjen apo ruajtjen e statusit të mirë mjedisor, në përputhje me Nenet 13(1), (2) dhe (3);		Neni 5, pika 1 shkronja (b), paragrafi i parë	b) faza e përcaktimit të programit të masave që do të merren për të arritur ose ruajtur statusin e mirë mjedisor të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 12 të këtij ligji, i cili duhet të përfshijë sa më poshtë:	E Pjeshsme	Vetëm neni 13, pikat 1 dhe 3 janë përafshuar nga ky projektligj.
Neni 1, pika 3	3. Strategjitë detare duhet të zbatojnë një qasje të bazuar tek ekosistemet në lidhje me menaxhimin e aktiviteteve njerëzore, duke siguruar që		Neni 5, pika 2	2. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar zbaton një qasje të bazuar në ekosistemet për menaxhimin e veprimtarive njerëzore, duke siguruar që	E Plotë	

	trysnia kolektive e aktiviteteve të tilla mbahet në nivele në përputhje me arritjen e statusit të mirë mjedisor dhe që kapaciteti i ekosistemeve detare për t'iu përgjigjur ndryshimeve të bëra nga dora e njeriut nuk kompromentohet, duke bërë të mundur njëkohësisht përdorimin e qëndrueshëm të mallrave dhe shërbimeve detare nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm.			presioni i përbashkët i këtyre veprimtarive të jetë brenda niveleve të pajtueshme me arritjen e një statusi të mirë mjedisor dhe të mos ndikojë në aftësinë e ekosistemeve detare për t'ju përgjigjur ndryshimeve të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, duke mundësuar përdorimin e qëndrueshëm të produkteve dhe shërbimeve detare nga brezat aktualë dhe të ardhshëm.		
Neni 5, pika 1	Çdo Shtet Anëtar në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të hartojë një strategji detare për ujërat e veta detare, në përputhje me planin e veprimit të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2.		Neni 5, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe organet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare, janë përgjegjëse për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë.	E Pjeshme	
Neni 17, pika 1 dhe 2	1. Shtetet Anëtare do të sigurohen për përditësimin e strategjive detare për çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë. 2. Për qëllimet e paragrafit nr. 1, Shtetet Anëtare do të shqyrtojnë në mënyrë të koordinuar, sic është referuar në Nenin 5, elementët e mëposhtëm të strategjive të tyre detare çdo gjashtë vjet pas hartimit të tyre për here të pare:		Neni 5, pika 5	5. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar do të përditësohet pas rishikimit që do të kryhet çdo 6 vjet, duke zbatuar një qasje të koordinuar, në përputhje me nenet 7 dhe 8 të këtij ligji, në lidhje me elementet e mëposhtëm:	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pikën 5, paragrafin e parë, pjesën e dytë e fjalisë është në përputhshmëri të plotë me referencën përkatëse në nenin 17, pika 1 dhe 2 të Direktivës

Neni 17, pika 2 shkronja (a)	(a) vlerësimin fillestar dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor, sic është parashikuar në Nenet 8(1) dhe 9(1) përkatësisht;		Neni 5, pika 5, paragrafi i dytë, shkronja (a)	a) vlerësimin fillestar dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor;	E pjeshme	Nenet 8(1) dhe 9(1) janë përafruar plotësisht nga ky Projektligj. (nenet 8 dhe 9 të projektligjit)
Neni 17, pika 2 shkronja (b)	(b) objektivat mjedisore të përcaktuara në përputhje me Nenin 10(1);		Neni 5, pika 5, paragrafi i dytë, shkronja (b)	b) objektivat mjedisore;	E pjeshme	Neni 10 (1) i Direktivës është përafruar plotësisht nga ky Projektligj. (nenet 10 dhe 16 pika 1 shkronja (c) e projektligjit)
Neni 17, pika 2 shkronja (c)	(c) programet e monitorimit të përcaktuara në përputhje me Nenin 11(1);		Neni 5, pika 5, paragrafi i dytë, shkronja (c)	c) programin e monitorimit;	E pjeshme	Neni 11 (1) i Direktivës është përafruar plotësisht nga ky Projektligj. (neni 11, pikat 1, 2, dhe 3 të projektligjit)
Neni 17, pika 2 shkronja (d)	(d) programet e masave të përcaktuara në përputhje me Nenin 13(2).		Neni 5, pika 5, paragrafi i dytë, shkronja (ç)	ç) programin e masave.	E pjeshme	Neni 13 (2) i Direktivës nuk është përafruar plotësisht nga ky Projektligj.
Neni 5 pika 1 dhe 2	1. Çdo Shtet Anëtar në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të hartojë një strategji detare për ujërat e veta detare, në përputhje me planin e veprimit të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2. 2. Shtetet Anëtare që kanë të përbashkëta rajone apo nën-rajone do të bashkëpunojnë për t'u siguruar që brenda çdo rajoni apo nën-rajoni detar masat që kërkohen për arritjen e objektivave të kësaj Direktive, në veçanti në lidhje me elementet e ndryshëm të strategjive detare të referuara në pikat (a) dhe (b) të jenë koherente dhe të		Neni 6, pika 1	1.Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, të cilat bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shteteve me të cilat Shqipëria ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare, me qëllim sigurimin e një veprimi koherent dhe qasje të koordinuar në zbatimin e masave për arritjen e objektivave të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji.	E Pjeshme	

	koordinuara përgjatë rajonit apo nën-rajonit detar në fjalë, në përputhje me planin e mëposhtëm të veprimit për të cilin Shtetet Anëtare në fjalë përpigën të ndjekin një qasje të përbashkët:					
Neni 5, pika 2 shkronja (a)	2 . Shtetet Anëtare që kanë të përbashkëta rajone apo nën-rajone do të bashkëpunojnë për t'u siguruar që brenda çdo rajoni apo nën-rajoni detar masat që kërkohen për arritjen e objektivave të kësaj Direktive, në veçanti në lidhje me elementet e ndryshëm të strategjive detare të referuara në pikat (a) dhe (b) të jenë koherente dhe të koordinuara përgjatë rajonit apo nën-rajonit detar në fjalë, në përputhje me planin e mëposhtëm të veprimit për të cilin Shtetet Anëtare në fjalë përpigën të ndjekin një qasje të përbashkët: (a) përgatitja:		Neni 6, pika 2	2. Përmes qasjes së koordinuar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare:	E Plotë	
Neni 5, pika 2 shkronja (a) (i)	(i) një vlerësim fillestar duhet të përfundojë deri me datë 15 Korrik 2012 në lidhje me statusin aktual mjedisor të ujërave në fjalë dhe ndikimin mjedisor të aktiviteteve njerëzore të zhvilluara në to, në përputhje me Nenin 8;		Neni 6, pika 2 shkronja (a)	a) kryejnë vlerësimin fillestar të statusit aktual mjedisor të ujërave detare dhe të ndikimit të veprimtarisë njerëzore në statusin e tyre, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;	E Pjesëme	Referenca e vendosur në nenin 6, pikën 2 shkronjën (a), të projektligjit (neni 8) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2, shkronjën (a) (i) të Direktivës. (neni 8 i Direktivës)

Neni 5, pika 2 shkronja (a) (ii)	(ii) përcaktim të statusit të mirë mjedisor që do të bëhet deri me datë 15 Korrik 2012 për ujërat në fjalë, në përputhje me Nenin 9(1);		Neni 6, pika 2 shkronja (b)	b) përcaktojnë statusin e mirë mjedisor, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji, brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;	E Plotë	Referenca e nenit 6, pika 2, shkronja (b) (neni 9 i projektligjit) e projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e nenit 5, pika 2 shkronja (a) (ii) e Direktivës(neni 9(1) i Direktivës)
Neni 5, pika 2 (a) (iii)	(iii) përcaktimin deri me datë 15 Korrik 2012 të një sërë objektivash mjedisore dhe treguesve përkatës, në përputhje me Nenin 10(1);		Neni 6, pika 2 shkronja (c)	c) identifikojnë/përcaktojnë objektivat mjedisore dhe treguesit e duhur për ujërat detare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;	E Pjesshme	Referenca e vendosur në nenin 6, pikën 2 shkronjën (c) të projektligjit (neni 10) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur nenin 5 pikën pikën 2 shkronjën (a) (iii) të Direktivës. (neni 10 pika 1)
Neni 5, pika 2 (a) (iv)	(iv) përcaktimin dhe implementimin deri me datë 15 Korrik 2014, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në legjislacionin përkatës të Komunitetit, të një programi monitorimi për një vlerësim në vazhdimësi dhe përditësim në vazhdimësi të objektivave, në përputhje me Nenin 11(1);		Neni 6, pika 2 (ç)	ç) hartojnë programin e monitorimit për vlerësimin e rregullt dhe përditësimin e objektivave mjedisore, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, i cili duhet të vihet në zbatim, brenda 6 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pikën 2 shkronjën (ç) të projektligjit (neni 11) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur nenin 5 pikën pikën 2 shkronjën (a) (iv) të Direktivës. (neni 11 pika 1)
Neni 5, 2 (b)	(b) Programi i masave		Neni, 6 pika 3	3. Përmes qasjes së përbashkët të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim më ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, ndërmarrin aktivitetet e nevojshme për:	E Plotë	

Neni 5, 2 (b) (i)	(i) hartimi, jo më vonë se viti 2015, i një programi masash për arritjen apo ruajtjen e statusit të mirë mjedisor, në përputhje me Nenin 13		Neni, 6 pika 3 shkronja (a)	a) hartimin e programit të masave që synojnë arritjen ose ruajtjen e një statusi të mirë mjedisor në ujërat e të dy nënrajoneve detare që janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, brenda 7 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 3 shkronja (a) e projektligjit, (neni 12) është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 5, pikën 2 shkronja (b) (i) e direktivës (neni 13)
Neni 5, 2 (b) (ii)	(ii) futjen në funksionim të programit të parashikuar në pikën (i), maksimumi deri në vitin 2016, në përputhje me Nenin 13(10). (1), (2) dhe (3);		Neni, 6 pika 3 shkronja (b)	b) vënien në zbatim të programit të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, brenda 1 viti nga miratimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë në përputhje me pikën 5 të nenit 5 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pika 2 shkronja b (ii) e direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 12 pikat 1, 2 dhe 3 të projektligjit)
Neni 5, pika 3 (paragrafi 1)	Shtetet Anëtare që kanë kufij në të njëjtin rajon apo nën-rajon detar të mbuluar nga kjo Direktivë duhet të përpilojnë një plan veprimi, ku statusi i detit është aq kritik sa të kërkojë ndërhyrje urgjente, në përputhje me paragrafin 1, i cili përfshin futjen më herët në fuqi të programit të masave, si edhe masa të mundshme mbrojtëse më të rrepta, me kusht që këto nuk parandalojnë arritjen apo ruajtjen e statusit të mirë mjedisor në një rajon apo nën-rajon tjetër detar		Neni 6, pika 5	5. Kur statusi i ujërave është aq kritik sa kërkohet ndërmarrja e një veprimi urgjent, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, si dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shteteve të tjera të interesuara, me të cilat ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare, kryejnë në një kohë më të hershme se afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni fazat e përcaktuara në këtë nen. Kjo përfshin vënien në zbatim më herët të programeve të masave, si dhe mundësisht masa më të rrepta,	E Plotë	

				me kusht që kjo të mos parandalojë arritjen ose mirëmbajtjen e një statusi të mirë mjedisor në një tjetër nënrajon detar.		
Neni 6, pika 1	1. Me qëllim realizimin e koordinimit të referuar në Nenin 5(2), Shtetet Anëtare në ato raste kur është praktike dhe e përshtatshme do të përdorin strukturat ekzistuese rajonale institucionale të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe ato të Konventave Rajonale Detare, që mbulojnë atë rajon apo nënrajon detar.		Neni 7	Për qëllimet e koordinimit me autoritetet kompetente të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, kur është e mundur, mund të përdorin strukturat ekzistuese të bashkëpunimit institucional rajonal, përfshirë Konventën për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja (Konventa e Barcelonës e vitit 1976) dhe 7 protokollat e saj.	E Plotë	
Neni 8, pika 1	1. Për çdo rajon apo nën-rajon detar, Shtetet Anëtare do të bëjnë një vlerësim fillestar të ujërave të tyre detare, duke marrë në konsideratë të dhënat ekzistuese, në rastet kur këto janë të disponueshme, dhe që përmbajnë sa më poshtë vijon:		Neni 8, pika 1	1. Vlerësimi fillestar i ujërave detare të nënrajonave detare I dhe II kryhet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe monitorimin e ujërave detare, bazuar në të dhënat ekzistuese, kur janë të disponueshme, si dhe duke përfshirë listat treguese të elementeve të ekosistemit, presioneve antropogjene dhe	E Plotë	

				veprimtarisë njerëzore që ka ndikim në ujërat detare, të tilla si:		
Neni 8, pika 1, shkronja (a)	(a) një analizë të veçorive dhe karakteristikave kryesore, si edhe të statusit aktual mjedisor të atyre ujërave, bazuar në lista indikative të elementeve të përcaktuar në Tabelën 1 të Aneksit III dhe që mbulon veçoritë fiziko-kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike;		Neni 8, pika 1, shkronja (a)	a) analizë të tipareve e karakteristikave thelbësore dhe statusit aktual mjedisor të këtyre ujërave, mbështetur në listën treguese të elementeve të përcaktuara në përputhje me nenin 18 të këtij ligji, dhe që mbulon tiparet fizike dhe kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike;	E pjesëshme	Neni 18 i projektligjit tregon bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor përmes së cilit do të transpozohen plotësisht të gjitha shtojcat e kësaj direktive.
Neni 8, pika 1 shkronja (b)	(b) një analizë të trysnive mbizotëruese dhe impakteve të tyre, duke përfshirë aktivitetin njerëzor, mbi statusin mjedisor të këtyre ujërave, i cili:		Neni 8, pika 1 shkronja (b)	b) analizë të presioneve dhe ndikimeve mbizotëruese, përfshirë veprimtarinë njerëzore, në statusin mjedisor të këtyre ujërave, e cila duhet:	E plotë	
Neni 8, pika 1 shkronja (b) (i)	(i) bazohet në listat indikative të elementeve të përcaktuar në Tabelën 2 të Aneksit III dhe mbulon përzierjen sasiore dhe cilësore të trysnive të ndryshme, si edhe tendencat e dallueshme;		Neni 8, pika 1 shkronja (b) (i)	i) të bazohet në listat treguese të elementeve të përcaktuara në zbatim të nenit 16 të këtij ligji, dhe përfshin një përzierje cilësore dhe sasiore të presioneve të ndryshme dhe tendencave të dukshme;	E plotë	
Neni 8, pika 1 shkronja (b) (ii)	(ii) mbulon efektet kryesore kumulative dhe sinergjike; dhe		Neni 8, pika 1 shkronja (b) (ii)	ii) të mbulojë ndikimet kryesore kumulative dhe sinergjike; dhe	E plotë	
Neni 8, pika 1 shkronja (b) (iii)	(iii) merr në konsideratë vlerësimet përkatëse që janë bërë në përputhje me legjislacionin ekzistues të Komunitetit;		Neni 8, pika 1 shkronja (b) (iii)	iii) të marrë parasysh vlerësimet e ndryshme përkatëse, të cilat janë bërë në përputhje me legjislacionin ekzistues;	E plotë	
Neni 8, pika 1 shkronja (c)	(c) një analizë ekonomiko-sociale të përdorimit të këtyre ujërave dhe të kostos së degradimit të mjedisit detar.		Neni 8, pika 1 shkronja (c)	c) analizë ekonomike dhe sociale të përdorimit të ujërave detare, si dhe të kostos së degradimit të mjedisit detar.	E plotë	

Neni 8, pika 2	<p>2. Analizat e referuara në paragrafin 1 do të marrin në konsideratë elementet që kanë të bëjnë me ujërat bregdetare, transnacionale dhe teritoriale që mbulohen nga dispozitat përkatëse të legjislacionit aktual të Komunitetit, në veçanti në Direktivën 2000/60/KE. Gjithashtu, ato do të marrin në konsideratë, apo të përdorin si bazë, vlerësime të tjera relevante si p.sh. vlerësimet e kryera në kuadrin e Konventave Rajonale Detare, me qëllim hartimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës të statusit të mjedisit detar.</p>		Neni 8, pika 2	<p>2. Analizat e përmendura në pikën 1 të këtij neni marrin parasysh elementet që lidhen me ujërat bregdetare, kalimtare dhe ato teritoriale në përputhje me legjislacionin e harmonizuar me kërkesat e Bashkimit Europian. Këto analiza marrin në konsideratë, ose bazohen në vlerësime të tjera përkatëse, të tilla si ato të kryera në kuadër të zbatimit të konventës rajonale të detit, me qëllim kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të statusit të mjedisit detar.</p>	E plotë.	Konventa Rajonale e Detit, i referohet Konventës së Barcelonës në kontekstin kombëtar.
Neni 8, pika 3	<p>3. Në përgatitjen e vlerësimeve sipas paragrafit 1, Shtetet Anëtare përmes koordinimit të përcaktuar në Nenet 5 dhe 6 do të bëjnë çdo përpjekje për tu siguruar që:</p> <p>(a) metodologjitë e vlerësimit të jenë konsistente për të gjitha rajonet apo nën-rajonet detare;</p> <p>(b) janë marrë në konsideratë veçoritë dhe impaktet ndërkuftare.</p>		Neni 8, pika 3	<p>3. Gjatë përgatitjes së vlerësimeve të statusit të ujërave detare, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe monitorimin e ujërave detare, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji, ndërmarrin hapa për të siguruar që metodologjitë e zbatuara të jenë në përputhje me metodologjitë e shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, si dhe që do të</p>	E Plotë	Referencat e vendosura në pjesën e parë të fjalisë të pikës 3 të nenit 8 , të projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencat e vendosura në nenin 8 pika 3 e Direktivës

				merren parasysh ndikimet dhe tiparet ndërkufitare.		
Neni 9, pika 1, pragrafi i parë	1. Duke i'u referuar vlerësimit fillestar të kryer sipas Nenit 8(1), Shtetet Anëtare në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të përcaktojnë për ujërat detare një grup karakteristikash për statusin e mirë mjedisor mbi bazën e përshkruesve cilësorë të rënditur në Aneksin I.		Neni 9, pika 1	1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, të hartuar në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, në lidhje me ujërat detare të të dy nënrajoneve detare I dhe II në Republikën e Shqipërisë, identifikojnë një sërë karakteristikash të statusit të tyre të mirë mjedisor, në bazë të karakteristikave cilësore të përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 9, pika 1 e projektligjit, është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 9, pika 1 paragrafi i parë i direktivës.
Neni 9, pika 1 paragrafi i dytë	Shtetet Anëtare do të marrin në konsideratë listat indikative të elementeve të përcaktuar në Tabelën 1 të Aneksit III dhe në veçanti vetite fiziko-kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike.		Neni 9, pika 2 (paragrafi 1)	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, gjatë përcaktimit të statusit të mirë mjedisor të ujërave detare të nënrajoneve detare I dhe II, marrin parasysh listat treguese të elementeve të përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, dhe në veçanti, tiparet fizike dhe kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike.	E Plotë	

Neni 9, pika 1 paragrafi i tretë	Shtetet Anëtare gjithashtu do të marrin në konsideratë trysnitë apo impaktet e aktiviteteve njerëzore në çdo rajon apo nën-rajon detar, në lidhje me listat indikative të përcaktuara në Tabelën 2 të Aneksit III.		Neni 9 pika 2 (paragrafi 2)	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, marrin parasysh edhe presionet apo ndikimet e veprimtarisë njerëzore mbi të dy nënrajonet detare I dhe II, duke pasur parasysh listën treguese të përcaktuar në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.	E Plotë	
Neni 10 pika 1, paragrafi 1	1. Mbi bazën e vlerësimit fillestar sipas Nenit 8(1), Shtetet Anëtare për çdo rajon apo nën-rajon detar do të përcaktojnë një grup objektivash mjedisore gjithëpërfshirëse, si edhe treguesit perkatës për ujërat e tyre detare, me qëllim udhëzimin e progresit drejt realizimit të statusit të mirë mjedisor në mjedisin detar, duke marrë në konsideratë listat indikative të trysnive dhe ndikimeve të tyre të përcaktuara në Tabelën 2 të Aneksit III dhe të karakteristikave të përcaktuara në Aneksin IV.		Neni 10, pika 1	1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, të kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për akuakulturën, në lidhje me ujërat detare të nënrajonëve detare I dhe II, përcaktojnë objektiva mjedisorë gjithëpërfshirëse dhe treguesit e lidhur me to për monitorimin e arritjes së statusit të mirë mjedisor në mjedisin detar. Për përcaktimin e këtyre objektivave do të merret parasysh lista treguese e presioneve dhe ndikimeve, si dhe lista treguese e karakteristikave në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.	E plotë	

Neni 10, pika 1, paragrafi 2	Gjatë përpunimit të këtyre objektivave dhe indikatorëve, Shtetet Anëtare do të marrin në konsideratë zbatimin në vazhdimësi të objektivave përkatëse ekzistuese mjedisore të parashtruara në nivel kombëtar, të Komunitetit apo ndërkombëtar në lidhje me të njëjtat ujëra, duke u siguruar që këto objektiva të jenë reciprokisht të përputhshme dhe që ndikimet ndërkufitare dhe veçoritë ndërkufitare të merren gjithashtu në konsideratë, në shkallën e mundur.		Neni 10, pika 2	2. Gjatë përcaktimit të objektivave mjedisore dhe treguesve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sigurohet zbatimi i të gjithë objektivave mjedisore ekzistuese të përcaktuara në përputhje me legjislacionin shqiptar, të Bashkimit Evropian dhe atë ndërkombëtar në lidhje me ujërat e nënrajoneve detare I dhe II, duke siguruar që këto objektiva të jenë të koordinuara, si dhe që ndikimet përkatëse ndërkufitare dhe tiparet ndërkufitare të jenë marrë gjithashtu në konsideratë, për aq sa është e mundur	E Plotë	
Neni 10, pika 2	Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin në lidhje me objektivat/targetet mjedisore brënda tre muajve të përcaktimit të tyre.		Neni 10, pika 3	3. Objektivat mjedisore dhe treguesit për monitorimin e arritjeve të tyre përcaktohen brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E plotë	
Neni 11, pika 1, paragrafi i parë	1. Mbi bazën e vlerësimit fillestar të kryer sipas Nenit 8(1), Shtetet Anëtare do të përcaktojnë dhe zbatojnë programe të koordinuara monitorimi për vlerësimin në vazhdimësi të statusit mjedisor të ujërave të tyre detare mbi bazën e listave indikative të elementeve të përcaktuar në Aneksin III dhe të listës së përcaktuar në Aneksin V, dhe sipas referencës të objektivave mjedisore të përcaktuara në përputhje me Nenin 10.		Neni 11, pika 1	1. Bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare në nënrajonet detare I dhe II, të kryer sipas nenit 8 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare, hartojnë një program ose disa programe monitorimi për vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor të këtyre ujërave, duke u mbështetur në listat treguese të elementeve dhe listën përkatëse të kërkesave të	E Plotë	

				përcaktuara në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, si dhe bazuar në objektivat mjedisore të përcaktuara në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.		
Neni 11, pika 1, paragrafi i dytë	Programet e monitorimit do të jenë në përputhje me rajonet apo nën-rajonet detare dhe do të bazohen dhe do të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse për vlerësim dhe monitorim të parashtruara në legjislacionin e Komunitetit, duke përfshirë Direktivat për Habitatet dhe Shpendet, apo sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.		Neni 11, pika 2,	2. Gjatë hartimit të programit të monitorimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sigurohet bashkëpunimi në rajon, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, me qëllim harmonizimin e vlerësimit dhe programeve përkatëse të monitorimit me ato të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, si dhe me legjislacionin që rregullon çështjet që lidhen me habitatet dhe shpendët e egra, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.	E Plotë	
Neni 11, pika 2	2. Shtetet Anëtare që kanë të përbashkët një rajon apo nën-rajon detar do të hartojnë programe monitorimi në përputhje me paragrafin 1 dhe në interes të koherences dhe koordinimit do të përpiqen të sigurojnë që: (a) metodat e monitorimit të jenë konsistente për të gjitha rajonet apo nën-rajonet detare, në mënyrë që të lehtësohet krahasueshmëria e rezultateve të monitorimit;		Neni 11, pika 3	Në përmbushje të këtij detyrimi dhe duke marrë parasysh nevojën për një qasje koherente dhe të koordinuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me autoritet përgjegjëse për monitorimin e ujërave detare, marrin masat e nevojshme për të siguruar që metodat për monitorimin e ujërave të të dy nënrajoneve detare I dhe II të jenë koherente dhe rezultatet e monitorimit të jenë të krahasueshme me metodat përkatëse të zbatuara dhe	E Plotë	

	(b) të merren në konsideratë ndikimet përkatëse ndërkuftare dhe veçoritë ndërkuftare.			rezultatet e arritura nga shtetet e tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi këto nënrajone detare, duke marrë gjithashtu parasysh ndikimet dhe tiparet ndërkuftare.		
Neni 5, pika 2, shkronja (a), (iv)	(iv) përcaktimin dhe implementimin deri me datë 15 Korrik 2014, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në legjislacionin përkatës të Komunitetit, të një programi monitorimi për një vlerësim në vazhdimësi dhe përditësim në vazhdimësi të objektivave, në përputhje me Nenin 11(1);		Neni 11, pika 4	4. Programi apo programet e monitorimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe vihen në zbatim brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 5 pika 2 shkronja (a) (iv) e Direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 11)
Neni 13, pika 1, paragrafi i parë	Shtetet Anëtare në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të evidentojnë masat që duhen ndërmarrë me qëllim arritjen apo ruajtjen e statusit të mirë mjedisor, sipas përcaktimit në përputhje me Nenin 9(1), në ujërat e tyre detare.		Neni 12, pika 1	1. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë përmban programin e masave që duhet të merren për të arritur dhe ruajtur statusin e mirë mjedisor të ujërave detare.	E Plotë	Referenca e vendosur në nenin 13 pika paragrafi i parë i Direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 9)
Neni 13, pika 1, paragrafi i dytë	Ato masa do të hartohen mbi bazën e vlerësimit fillestar të bërë sipas Nenit 8(1) dhe duke i'u referuar objektivave mjedisore të përcaktuara sipas Nenit 10(1), dhe duke marrë në konsideratë llojet e masave të rënditura në Aneksin VI.		Neni 12, pika 2	2. Masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni: a) hartohen në bazë të vlerësimit fillestar të miratuar të statusit të ujërave detare në zbatim të nenit 8 të këtij ligji; b) planifikohen në mënyrë të tillë që realizimi i tyre të shërbejë për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në zbatim të nenit 10 të këtij ligji;	E Plotë	Referencat e vendosura në nenin 12, pika 2 e projektligjit janë në përputhshmëri të plotë me referencat e vendosura në nenin 13, pika 1 paragrafi 2 i direktivës

				c) planifikohen brenda afateve të përcaktuara në vendimin në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.		
Neni 13, pika 3, paragrafi i parë	Gjatë hartimit të programit të masave sipas paragrafit 2, Shtetet Anëtare do t'i japin vëmëndjen e duhur zhvillimit të qëndrueshëm dhe në veçanti ndikimeve sociale dhe ekonomike të masave të parashikuara. Për tu ardhur në ndihmë autoritetit apo autoriteteve kompetente të referuara në Nenin 7 për të ndjekur objektivat e tyre në mënyrë të integruar, Shtetet Anëtare mund të evidentojnë apo të përcaktojnë kuadro/struktura administrative për të përfituar nga ky ndërveprim.		Neni 12, pika 3, shkronjat (a) dhe (b)	3. Gjatë përcaktimit të masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me organin përgjegjës për zonat e mbrojtura detare: a) marrin në konsideratë masat përkatëse të ndërmarra në bazë të legjislacionit për burimet ujore, si dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor që rregullon trajtimin e ujërave të ndotura urbane, cilësinë e ujërave të larjes dhe marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse; b) marrin parasysh zhvillimin e qëndrueshëm dhe, në veçanti, ndikimet ekonomike dhe sociale të masave të parashikuara;	E Plotë	
Neni 13, pika 3, paragrafi i dytë	Shtetet Anëtare do të sigurohen që këto masa të jene efektive përsa i përket kostos dhe teknikisht të mundshme dhe do të kryejnë vlerësime të ndikimit, duke përfshirë analiza të përfitimit të kostos, përpara prezantimit të çdo mase të re.		Neni 12, pika 3, shkronjat (c) dhe (ç)	c) sigurojnë që masat të jenë me kosto efektive dhe teknikisht të realizueshme; ç) kryejnë vlerësimin e ndikimit, duke përfshirë analizën e kostos dhe përfitimit, përpara përcaktimit të çdo mase të re;	E plotë	
Neni 13, pika 4	Programet e masave të përcaktuara në përputhje me këtë Nen do të përfshijnë masa për mbrojtjen hapsinore, duke		Neni 12, pika 4, shkronjat (a) dhe (b)	4. Programi i masave i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfshin gjithashtu masat e mbrojtjes hapësinore me qëllim:	E Plotë	Përmes ligjit nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe ligjit 9587 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, të ndryshuar,

	kontribuar në rrjete koherente dhe përfaqësuese të zonave të mbrojtura detare, duke mbuluar në mënyrë adekuate diversitetin e ekosistemeve, si p.sh.: zonat e veçanta të ruajtjes sipas Direktives për Habitatet, zona të mbrojtjes se veçantë sipas Direktives për Shpendet dhe zona të mbrojtura detare sipas marrëveshjeve me Komunitetin apo me Shtetet Anëtare në fjalë në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare apo rajonale ku ato janë palë.			a) dhënien e kontributit në rrjetet koherente dhe përfaqësuese të zonave të mbrojtura detare; dhe; b) mbulimin në mënyrën e duhur të larmisë së ekosistemeve përbërëse, të tilla si zonat e veçanta të ruajtjes, të përcaktuara në përputhje me legjislacionin për habitatet, zonat e veçanta të mbrojtura të përcaktuara në përputhje me legjislacionin për shpendët e egra, zonat e mbrojtura detare, të përcaktuara së bashku me shtetet e tjera në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat ato janë palë.		është përfaqësues pjesërisht Direktiva e Habiteteve (92/43/EEC) Gjithashtu përmes VKM-së 866, datë 10.12.2014 janë përfaqësuar plotësisht anekset e Anekset I, II, IV dhe V, të direktivës 92/43/EEC, si dhe Aneksi V i direktivës 2009/147/EC për ruajtjen e shpendëve të egër
Neni 13, pika 6	Jo më vonë se viti 2013, Shtetet Anëtare do të japin për publikun informacione përkatëse në lidhje me çdo rajon apo nën-rajon detar, të referuara në paragrafët 4 dhe 5.		Neni 12, pika 4, paragrafi i fundit	Informacioni përkatës për zonat e veçanta të ruajtjes dhe zonat e veçanta të mbrojtjes në të dy nënrajonet detare I dhe II do të vihet në dispozicion të publikut nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, brenda 8 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E Plotë	
Neni 13, pika 7	Shtetet Anëtare do të tregojnë në programet e tyre të masave mënyrën sesi do të zbatohen masat dhe si ato do të kontribuojnë në arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në përputhje me Nenin 10(1).		Neni 12, pika 5	5. Programi i masave përmban, ndër të tjera, udhëzime për mënyrën e zbatimit të masave dhe si do të kontribuojnë ato në arritjen e objektivave mjedisore në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.	E Pjesëshe	Referenca e vendosur në nenin 12, pika 5 e projektligjit është në përputhshmëri të plotë me referencën e vendosur në nenin 13, pika 7 e Direktivës
Neni 13, pika 8	Shtetet Anëtare do të marrin në konsideratë implikimet e		Neni 12, pika 3, shkronja (d)	d) marrin në konsideratë ndikimet e zbatimit të programit të	E Plotë	

	programeve të tyre të masave në ujërat përtej ujërave të tyre detare me qëllim minimizimin e riskut të dëmtimeve dhe në rast se është e mundur të sigurojnë një impakt pozitiv në ato ujera.			masave në ujëra përtej ujërave të tyre detare, me qëllim uljen e rrezikut të dëmtimit, dhe nëse është e mundur, të ketë një ndikim pozitiv në këto ujëra.		
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë	Një Shtet Anëtar mund të evidentojë raste brënda ujërave të veta detare ku për ndonjë nga arsyet e përmendura me poshtë në pikat (a) deri në (d), objektivat mjedisore ose statusi i mirë mjedisor nuk mund të plotësohen në çdo aspekt përmes masave që ndërmerren nga ai Shtet Anëtar, apo për arsyet e parashtruara në pikën (e), ato mund të mos arrihen brenda afatit në fjalë:		Neni 13, pika 1	1. Programi i masave, i përcaktuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, mund të identifikojë rastet kur objektivat mjedisore dhe statusi i mirë mjedisor, në ujërat e Detit Adriatik dhe Detit Jon të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të arrihen në çdo aspekt përmes masave të marra dhe brenda afateve kohore në fjalë për shkaqet e mëposhtme:	E Plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë shkronja (a)	(a) veprim apo mungesë veprimi për të cilin Shteti Anëtar në fjalë nuk është përgjegjës;		Neni 13, pika 1, shkronja (a)	a) kur veprimi ose mosveprimi nuk është përgjegjësi e autoriteteve kompetente shqiptare;	E plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë shkronja (b)	(b) shkaqe natyrore;		Neni 13, pika 1, shkronja (b)	b) shkaqe natyrore;	E plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë	(c) forca madhore;		Neni 13, pika 1, shkronja (c)	c) forca madhore;	E plotë	

shkronja (c)						
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë shkronja (d)	(d) modifikime apo ndryshime të karakteristikave fizike të ujërave detare të shkaktuara nga veprime të ndërmarra për arsye të interesit publik që janë mbi ndikimin negativ në mjedis, duke përfshirë ndikime të mundshme ndërkuftare;		Neni 13, pika 1, shkronja(ç)	ç) shtesat ose ndryshimet e karakteristikave fizike të ujërave detare vijnë si pasojë e veprimeve të ndërmarra për shkak të një interesi publik madhor, i cili tejkalon ndikimin negativ në mjedis, përfshirë çdo ndikim ndërkuftar;	E plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i parë shkronja (e)	(e) kushtet natyrore që nuk lejojnë përmirësimin në kohë të statusit të ujërave detare në fjalë.		Neni 13, pika 1, shkronja (d)	d) kushtet natyrore janë të tilla që nuk lejojnë përmirësimin në kohë të statusit të ujërave detare në fjalë.	E plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i dytë	Shteti Anëtar në fjalë do të evidentojë qartësisht këto raste në programet e veta të masave dhe do të mbeshtesë pikepamjet e tij përpara Komisionit. Në evidentimin e rasteve, një Shtet Anëtar do të marrë në konsideratë pasojat për Shtetet Anëtare në rajonin apo nën-rajonin detar në fjalë.		Neni 13, pika 2	2. Njëkohësisht me identifikimin e rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të shqyrtohen edhe pasojat që mund të vijnë nga mosarritja e objektivave mjedisore dhe statusi i mirë mjedisor në shtetet e tjera, në të dy nënrajonet detare I dhe II.	E Plotë	
Neni 14, pika 1, paragrafi i tretë	Megjithatë, Shteti Anëtar në fjalë do të ndërmarrë masat e duhura të përkoheshme për të vazhduar që të ndjeke objektivat mjedisore, me qëllim parandalimin e metejshëm të degradimit të ujërave detare të ndikuara për arsyet e përmendura në pikat (b), (c) apo		Neni 13, pika 3	3. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, marrin masa të posaçme me qëllim parandalimin e përkeqësimit të	E Plotë	

	(d) dhe për të zbutur ndikimin negativ në nivelin e rajonit apo nën-rajonit detar në fjalë apo në ujërat detare të Shteteve të tjera Anëtare.			mëtejshëm të statusit të ujërave detare të prekur nga shkaqet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni dhe zbutjen e ndikimit negativ brenda nënrajoneve detare I dhe II ose ujërave të shteteve të tjera.		
Neni 14, pika 2	Në situatën e përshkruar në paragrafin 1(d), Shtetet Anëtare do të sigurohen që modifikimet apo ndryshimet nuk përjashtojnë apo kompromentojnë në mënyrë të përherëshme arritjen e statusit të mirë mjedisor në nivelin e rajonit apo nën-rajonit detar në fjalë apo të ujërave detare të Shteteve të tjera Anëtare.		Neni 13, pika 4	4. Në rastin e shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, do të marrin masa në mënyrë që ndryshimet dhe shtesat të mos përjashtojnë ose çënojnë në mënyrë të pakthyeshme arritjen e statusit të mirë mjedisor në nënrajonet detare I dhe II ose ujërat detare të shteteve të tjera.	E Plotë	
Neni 14, pika 3	Masat e përkohshme të përshkruara në nën-paragrafin e tretë të paragrafit 1 do të integrohen aq sa të jetë e mundur në programet e masave.		Neni 13, pika 5	5. Masat e posaçme të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, kur është e mundur, do të përfshihen në programin e masave.	E Plotë	
Neni 14, pika 4, paragrafi i parë	Shtetet Anëtare do të zhvillojnë dhe zbatojnë të gjitha elementet e strategjive detare të përshkruara në Nenin 5(2), por me përjashtim të vlerësimit fillestar të përshkruar në Nenin 8 nuk do të kërkohet të ndërmerren hapa specifike aty ku nuk ka rresik domethenës ndaj mjedisit detar, apo ku kostot do		Neni 14, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministria përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e të gjithë elementeve të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, në	E Plotë	Referencat e vendosura në nenin 14, pika 1 e projektligjit janë në përputhshmëri të plotë me referencat e vendosura në nenin 14, pika 4 paragrafi i parë i Direktivës.

	të ishin në disproporcion duke marrë në konsideratë rreziqet ndaj mjedisit detar, si edhe me kusht që të mos ketë degradim të metejshëm.			zbatim të nenit 5 dhe 6 të këtij ligji, por nuk i kërkohet që, përveç vlerësimit fillestar të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji, të ndërmarrin hapa të veçantë nëse nuk ka rrezik të konsiderueshëm për mjedisin detar, ose kur kostot do të ishin joproporcionale duke marrë parasysh rreziqet në mjedisin detar, dhe me kusht që të mos ketë përkeqësim të mëtejshëm.		
Neni 14, pika 4, paragrafi i dytë	Në ato raste kur për këto arsye një Shtet Anëtar nuk ndërmerr hapa, ai duhet t'i paraqesë Komisionit argumentat e nevojshme ku mbeshteten vendimet tij, duke shmangur kompromentimin e përhershëm të arritjes së statusit të mirë mjedisor.		Neni 14, pika 2	2. Nëse për ndonjë prej shkaqeve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministria përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, nuk ndërmarrin asnjë hap, do ta bëjnë publik këtë fakt, si dhe do të njoftojnë Këshillin e Ministrave, i cili merr masat t'i paraqesë Komisionit Evropian arsyetimin e nevojshëm ku është mbështetur ky vendim, duke shmangur që arritja e statusit të mirë mjedisor të çenohet në mënyrë të pakthyeshme.	E plotë	
Neni 19, pika 1	Në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit, Shtetet Anëtare do të sigurohen që të gjitha palëve të interesuara tu jepen mundesi në kohe dhe efikase për të marrë pjesë në zbatimin e kësaj Direktive, duke përfshirë aty ku është e mundur,		Neni 15, pikat 1 dhe 2	1. Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë akses në informacionin mjedisor, sipas legjislacionit përkatës.	E Plotë	

	entitete apo struktura ekzistuese administrative, duke përfshirë Konventat Rajonale Detare, Organet këshillimore shkencore dhe Këshillat Këshillimor Rajonale.			2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë mundësi për të marrë pjesë në zbatimin e kërkesave të këtij ligji, duke përfshirë, kur është e mundur, organet ekzistuese të menaxhimit ose strukturat e Konventës së Barcelonës, si dhe organe të tjerë shkencore këshillimore të njohura ndërkombëtarisht.		
Neni 19, pika 3, paragrafi i parë	Në lidhje me aksesin për informacionin mjedisor do të zbatohet Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 28 janar 2003 që parashikon aksesin e publikut ndaj informacionit mjedisor(.		Neni 15, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore organizon konsultime publike në lidhje me Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit Detar, në përputhje me legjislacionin për konsultimin publik.	E plotë	
Neni 19, pika 2	Shtetet Anëtare do të publikojnë dhe do të venë në dispozicion të publikut për komente, përmbledhje të elementeve të mëposhtëm të strategjive të tyre detare, apo përditësimet përkatëse si me poshtë vijon:		Neni 15, pika 4	4. Përveç detyrimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, gjatë fazës së përgatitjes së dokumenteve të mëposhtme, publikon përmbledhje të shkurtra dhe më qëllim për t'i dhënë publikut mundësinë e komenteve mbi elementet vijues të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar, si dhe të gjitha ndryshimeve për:	E Plotë	
Neni 19, pika 2, shkronja (a)	(a) vlerësimin fillestar dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor, sic është parashikuar në Nenet 8(1) dhe 9(1) përkatësisht;		Neni 15, pika 4, shkronja (a)	a) vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe përcaktimin e statusit të mirë	E Plotë	Referencat e vendosura në nenin 14, pika 4 shkronja (a) e projektligjit, janë në përputhshmëri të plotë me referencat e vendosura në

				mjedisor, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;		nenin 19, pika 2 shkronja (a) e projektligjit.
Neni 19, pika 2, shkronja (b)	(b) objektivat mjedisore të përcaktuara në përputhje me Nenin 10(1);		Neni 15, pika 4, shkronja (b)	b) objektivat mjedisorë, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;	E plotë	
Neni 19, pika 2, shkronja (c)	(c) programet e monitorimit të përcaktuara në përputhje me Nenin 11(1);		Neni 15, pika 4, shkronja (c)	c) programin e monitorimit, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji; dhe	E plotë	
Neni 19, pika 2 shkronja (d)	(d) programet e masave të përcaktuara në përputhje me Nenin 13(2).		Neni 15, pika 4, shkronja (ç)	ç) programin e masave, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji.	E pjesshme.	Neni 13, pika 2 e Direktivës nuk është përafruar plotësisht nga ky projektligji.
Neni 7, pika 1, paragrafi 1	Deri më datë 15 korrik 2010, Shtetet Anëtare për çdo rajon apo nën-rajon detar në fjalë do të përcaktojnë autoritetin apo autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Direktive në lidhje me ujërat e tyre detare.		Neni 16, pika 1,	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon, të paktën në faqen e saj të internetit sa më poshtë vijon:	E Plotë	
Neni 7, pika 1, paragrafi 2	Deri më datë 15 janar 2011, Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin Komisionit një listë të autoriteteve kompetente të përcaktuara, së bashku me artikujt e informacionit të rënditur në Aneksin II.		Neni 16, pika 1, shkronja (a)	a) listën e autoriteteve kompetente të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë informacionin e nevojshëm për to, të përcaktuar në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji;	E plotë	
Neni 7, pika 1, paragrafi 3	Në të njëjtën kohë, Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë Komisionit një listë të autoriteteve të tyre kompetente në lidhje me njësite ndërkombëtare në të cilat ato marrin pjesë dhe që janë		Neni 16, pika 1, shkronja (b)	b) listën e autoriteteve kompetente të ngarkuara për të bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare, me të cilat bashkëpunon Republika e Shqipërisë, brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi të këtij ligji;	E Plotë	

	relevante për zbatimin e kësaj Direktive.					
Neni 8, pika 1, paragrafi i parë	Për çdo rajon apo nën-rajon detar, Shtetet Anëtare do të bëjnë një vlerësim fillestar të ujërave të tyre detare, duke marrë në konsideratë të dhënat ekzistuese, në rastet kur këto janë të disponueshme, dhe që përmbajnë sa më poshtë vijon:		Neni 16, pika 1, shkronja (c)	c) informacionin për vlerësimin fillestar të kryer të statusit të ujërave detare të nënrajoneve detare I dhe II, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;	E Plotë	
Neni 10, pika 2	Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin në lidhje me objektivat/targetet mjedisore brënda tre muajve të përcaktimit të tyre.		Neni 16, pika 1, shkronja (ç)	ç) informacionin për objektivat mjedisore të ujërave të nënrajoneve detare I dhe II;	E Plotë	
Neni 11, pika 3	3. Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin në lidhje me programet e monitorimit brënda tre muajve nga përcaktimi i tyre.		Neni 16, pika 1, shkronja (d)	d) informacion mbi programin e monitorimit të hartuar në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;	E Plotë	
Neni 13, pika 9	Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin dhe çdo Shtet tjetër Anëtar në fjalë në lidhje me programet e tyre të masave brënda tre muajve nga përcaktimi i këtyre masave.		Neni 16, pika 1, shkronja (dh)	dh) informacion mbi programin e masave të hartuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji;	E Plotë	
Neni 14, pika 4, paragrafi i dytë	Në ato raste kur për këto arsye një Shtet Anëtar nuk ndërmerr hapa, ai duhet t'i paraqesë Komisionit argumentat e nevojshme ku mbeshteten vendimet tij, duke shmangur kompromentimin e përhershëm të arritjes së statusit të mirë mjedisor.		Neni 16, pika 1, shkronja (e)	e) arsyet për shkaqet e mosveprimit në zbatim të nenit 14 të këtij ligji;	E Plotë	

Neni 17, pika 3	3. Detaje të cdo përditësimi të bëra pas rishikimeve të përcaktuara ne paragrafin 2 do t'i paraqiten Komisionit, Konventave Rajonale Detare dhe çdo Shteti Anëtar në fjalë brënda tre muajve nga publikimi i tyre në përputhje me Nenin 19(2).		Neni 16, pika 1, shkronja (ë)	ë) informacionin mbi detajet e çdo përditësimi të Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, i cili sigurohet t'i dërgohet Sekretariatit të Konventës së Barcelonës dhe shteteve të tjera që ndajnë me Republikën e Shqipërisë sovranitetin mbi ujërat e nënrajoneve detare I dhe II.	E Plotë	Neni 19 (2) i Direktivës është transpozuar plotësisht nga ky Projektligji. (neni 15 pika 4 e projektligjit)
Neni 7, pika 1, paragrafi 2	Deri më datë 15 janar 2011, Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin Komisionit një listë të autoriteteve kompetente të përcaktuara, së bashku me artikujt e informacionit të rënditur në Aneksin II.		Neni 16, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon, të paktën në faqen e saj të internetit për çdo ndryshim të informacionit që përmbahet në listat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, brenda 6 muajve nga data e ndryshimit.	E Plotë	
Neni 15, pika 1	Në ato raste kur një Shtet Anëtar evidenton një çështje që ka ndikim në statusin mjedisor të ujërave të veta detare dhe e cila nuk mund të trajtohet përmes masave të marra në nivel kombëtar, apo që lidhet me një politike tjetër të Komunitetit apo me një marrëveshje ndërkombëtare, ky Shtet Anëtar do të informoje Komisionin në përputhje me rrethanat dhe do të paraqesë argumente për të mbeshetur pikepamjet e veta. Komisioni do të përgjigjet brënda një periudhe gjashtë mujore.		Neni 16, pika 3	3. Në rast se Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare, gjykojnë që një çështje që ka ndikim në statusin mjedisor të ujërave të nënrajoneve detare I dhe II të Republikës së Shqipërisë nuk mund të trajtohet nga masat e marra nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, ose nëse ekziston një rast që lidhet me zbatimin e ndonjë politike tjetër të Bashkimit Evropian apo që lind nga zbatimi i një marrëveshje ndërkombëtare, njofton Këshillin	E Plotë	

				e Ministrave, i cili merr masat për informimin e Komisionit Evropian sipas rrethanave, duke paraqitur arsyetimin përkatës.		
Neni 18	Brenda tre viteve nga publikimi i programeve të masave apo nga përditësimet përkatëse të tyre, në përputhje me Nenin 19 (2), Shtetet Anëtare do t'i paraqesin Komisionit një raport konciz të ndërmjetëm ku të përshkruhet ecuria në zbatimin e atij programi.		Neni 16, pika 4	4. Brenda 3 viteve nga botimi i çdo programi masash apo përditësimi të tij, në zbatim të shkronjave “a”; “b”; “c” dhe “ç”, të pikës 4, neni 15, të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përgatit një raport të ndërmjetëm të shkurtuar, i cili përshkruan progresin e arritur në zbatimin e këtij programi	E Plotë	
Neni 19, pika 3, paragrafi i 2	Në përputhje me Direktiven 2007/2/KE, Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin Komisionit, për kryerjen e detyave të veta në lidhje me këtë Direktive, në veçanti në lidhje me rishikimin e statusit të mjedisit detar në Komunitet, sipas Nenit 20(3)(b), me aksesin dhe të drejtat e përdorimit në lidhje me të dhënat dhe informacionin që rezultojnë nga vlerësimet fillestare të bëra në përputhje me Nenin 8 dhe nga programet e monitorimit në përputhje me Nenin 11.		Neni 17, pika 1	1. Në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore garanton përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit të legjislacionit evropian për të drejtën e informacionit gjeohapësinor, të drejtën për akses dhe përdorim të të dhënave si dhe informacionit që rezultojnë nga vlerësimi fillestar të kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, e nga programet e monitorimit të përcaktuara në zbatim të nenit 11 të këtij ligji.	E Plotë	
Neni 19, pika 3, paragrafi i 3	Jo me vonë se gjashtë muaj pas marrjes të të dhënave dhe informacionit që rezultojnë nga vlerësimi fillestar i bërë në përputhje me Nenin 8 dhe nga programet e monitorimit të		Neni 17, pika 2	2. AMBU siguron që, informacioni nga vlerësimi fillestar i kryer në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, dhe nga programet e monitorimit të përcaktuara në zbatim të nenit 11 të këtij ligji, t'i	E Plotë	

	hartuara në përputhje me Nenin 11, ky informacion dhe këto të dhëna gjithashtu do t'i vihen në dispozicion Agjencisë Europiane të Mjedisit për kryerjen e detyrave të saj.			vihet në dispozicion Agjencisë Evropiane të Mjedisit, jo më vonë se 6 muaj pasi këto të dhëna të jenë bërë të disponueshme.		
Shtojcat I deri VI të direktivës	<p>ANEKSI I. Përshkruesit cilësorë për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor</p> <p>ANEKSI II. Autoritetet Kompetente</p> <p>ANEKSI III .Listat indikative të karakteristikave, trysnive dhe impakteve</p> <p>ANEKSI IV. Lista indikative e karakteristikave që do të merren në konsideratë në përcaktimin e objektivave mjedisore</p> <p>ANEKSI V. Programet e Monitorimit</p> <p>ANEKSI VI. Programet e masave</p>		Neni 18	<p>1. Për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton metodologjinë për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë në të cilën përfshihen:</p> <p>a) elementet që duhet të përmbajnë dy fazat që ndiqen për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë;</p> <p>b) lista treguese e elementeve të ekosistemit, presioneve antropogjene dhe veprimtarisë njerëzore në ujërat detare;</p> <p>c) elementet përshkruese cilësore për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor të ujërave detare;</p> <p>ç) elementet që duhet të përmbajë informacioni mbi autoritetet kompetente;</p> <p>d) lista treguese e karakteristikave që do të merren parasysh gjatë përcaktimit të objektivave mjedisore për nënrajonet detare në Republikën e Shqipërisë;</p>	I Papërputhur	Pika 2 e nenit 18 përcakton bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor përmes së cilit do të transpozohen plotësisht të gjitha shtojcat e kësaj direktive.

				<p>dh) elementet që duhet të përmbajnë programet e monitorimit;</p> <p>e) elementet që duhet të përmbajnë programet e masave.</p> <p>2. Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit Detar të Republikës së Shqipërisë, miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>		
--	--	--	--	--	--	--